

VENDIM
Nr.35, datë 27.1.1997

**PËR FONDIN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR STATUSIN E VETERANIT TË
LUFTËS PËR VITIN 1997**

Në zbatim të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për shpenzimet administrative për Komisionin Qendror dhe Departamentin e Veteranëve për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, për mbrojtjen e vendimeve të Komisionit Qendror në gjyqe, për mbulimin e shpenzimeve të gjyqeve të humbura, për pagesat e punonjësve të punësuar përkohësisht (me kontratë) të Departamentit, për mbledhjet e Komisionit Qendror, shtypshkrime tipografike, kancelari etj., për vitin 1997 caktohen 1.6 milionë lekë, që përfshihen në buxhetin e vitit 1997 për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi